<p>5.rregullat dhe procedurat për:</p> <p>5.1.ndryshimin e statutit;</p> <p>5.2 bashkimin, ndarjen ose shuarjen e organizatës; dhe</p> <p>5.3. shpërndarjen e mjeteve që mbesin pas shuarjes;</p> <p>6. Përveç të dhënave të parapara me paragrafin tre (3) të këtij neni, statuti i shoqatës përmban edhe procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim, dhe nëse organizata vendos të ketë një organ të ndërmjetëm, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të organit të ndërmjetëm dhe ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiive ndërmjet Kuvendit të anëtarëve dhe organit të ndërmjetëm.</p> <p>7. Statuti i OJQ-së mund të përmbajë çdo rregull, dispozitë apo procedurë tjetër, që nuk është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Ligj dhe me ligjet tjera në fuqi.</p> <p>8. Rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ – së, duhet të jenë në pajtim me parimet</p>	<p>5.rules and procedures for:</p> <p>5.1. amending the statute;</p> <p>5.2 merging, splitting or dissolving of the organization; and</p> <p>5.3. distribution of assets remaining following the dissolving;</p> <p>6. In addition to the data provided under paragraph three (3) of this Article, the statute of the association shall contain the procedures for selecting and removing members, membership terms and should the organization decide to have an intermediate body, the procedures for selection and removal of the members of the intermediary body and division of competences and responsibilities between the assembly of members and the intermediary body.</p> <p>7. The NGO Statute shall contain any other rule, provision or procedure that is not in contrary with the conditions provided by this Law and other applicable laws.</p> <p>8. The rules and procedures for internal governance contained in the NGO's statute must be in accordance with democratic</p>	<p>5. pravila i procedure za:</p> <p>5.1. promenu statuta;</p> <p>5.2.spajanje, odvajanje i raspuštanje organizacije; i</p> <p>5.3.raspodelu sredstava koje ostaju nakon raspuštanja;</p> <p>6. Pored predviđenih podataka u stavu tri (3) ovog člana, statut udruženja sadrži procedure za izbor i razrešenje članova, uslove za učlanjenje, i ukoliko organizacija odluči da ima srednji organ, procedure za izbor i razrešenje članova srednjeg organa i podelu nadležnosti i odgovornosti između Skupštine članova i srednjeg organa.</p> <p>7. Statut NVO-a može da sadrži bilo koje drugo pravilo, odredbu ili proceduru, koja nije u suprotnosti sa predviđenim uslovima u ovom Zakonu i drugim važećim zakonima.</p> <p>8. Pravila i procedure za unutrašnje rukovođenje koje sadrži statut NVO-a, moraju biti u skladu sa demokratskim</p>
---	--	---

<p>demokratike.</p> <p>9. OJQ zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe ligj.</p> <p>10. Për të lehtësuar përgatitjen e statutit, Departamenti përgatit modele të statutit për secilën formë të organizimit të OJQ-së, të cilat mund të përdoren nga OJQ-ja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Asociimi i Personave Juridik</p> <p>Personat juridik, duke përfshirë edhe OJQ-të, mund të themelojnë shoqata, fondacione apo institute për të përparuar qëllimin e tyre të ligjshëm, qoftë për përfitim publik apo të ndërsjellë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>KAPITULLI V-REGJISTRIMI I OJQ-së</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Regjistrimi</p> <p>1.OJQ, pavarësisht nga forma e organizimit, si shoqatë, fondacion apo institut, regjistrohet në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj.</p>	<p>principles.</p> <p>9. The NGO performs its activities in accordance with the Statute and the Law.</p> <p>10. To facilitate the preparation of the statute, the Department prepares statute samples for each form of organization of an NGO, which can be used by the NGO.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Association of Legal Persons</p> <p>Legal entities, including NGOs, may establish associations, foundations or institutes to advance their legitimate purpose, whether for public or mutual benefit, in accordance with the conditions set forth in this law.</p> <p>CHAPTER V-REGISTRATION OF A NGO</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Registration</p> <p>1. The NGO shall, regardless of the form of organization as an association, foundation or institute, shall be registered in accordance with the criteria and procedures</p>	<p>principima.</p> <p>9. NVO razvija svoje aktivnosti u skladu sa Statutom i zakonom.</p> <p>10. Kako bi olakšalo pripremu statuta, Odeljenje priprema modele statuta za svaki oblik organizovanja NVO-a, koje NVO može koristiti.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Udruživanje pravnih lica</p> <p>Pravna lica, uključujući i NVO, mogu osnivati udruženja, fondacije ili institute radi unapređenja njihovih zakonitih ciljeva, bilo za javnu korist ili uzajamno, u skladu sa uslovima predviđenim u ovom zakonu.</p> <p>POGLAVLJE V-REGISTRACIJA NVO-a</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Registracija</p> <p>1.NVO, bez obzira na oblik organizovanja, kao udruženje, fondacija ili institut, registruje se u skladu sa kriterijumima i procedurama propisanim</p>
---	--	--

<p>2. Asnjë person nuk obligohet të regjistrojë OJQ-në për të ushtruar të drejtën e lirisë në asociim.</p> <p>3. OJQ regjistrohet në Departament, në mënyrë që të veprojë si person juridik në Kosovë.</p> <p>4. Kërkesës për regjistrim i bashkëngjiten këto dokumente:</p> <p>4.1. akti i themelimit;</p> <p>4.2. statuti;</p> <p>4.3. kopjen e letërnjoftimit të themeluesve dhe përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së;</p> <p>4.4. certifikatën e regjistrimit për personat juridik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Përfaqësuesi i Autorizuar</p>	<p>set forth under this law.</p> <p>2. No person is obliged to register the NGO to exercise the right on freedom of association.</p> <p>3. The NGO shall be registered within the Department in order to operate as a legal person in Kosovo.</p> <p>4. The following documents shall accompany the registration application form:</p> <p>4.1. founding act;</p> <p>4.2. statute;</p> <p>4.3. copy of the ID of founders and of the authorized representative of the NGO;</p> <p>4.4. Registration certificate for legal persons.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Authorized Representative</p>	<p>ovim zakonom.</p> <p>2. Nijedno lice se ne obavezuje da registruje NVO za vršenje prava slobode u udruživanju.</p> <p>3. Registracija NVO-a se vrši u Odeljenju, kako bi delovala kao pravno lice na Kosovu.</p> <p>4. Zahtevu za registraciju se prilažu sledeći dokumenti:</p> <p>4.1. osnivački akt;</p> <p>4.2. statut;</p> <p>4.3. kopija lične karte osnivača i ovlašćenog predstavnika NVO-a;</p> <p>4.4. sertifikat registracije za pravna lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Ovlašćeni predstavnik</p>
<p>1. OJQ cakton me shkrim përfaqësuesin e autorizuar.</p> <p>2. OJQ zgjedh përfaqësuesin e autorizuar, i</p>	<p>1. NGO shall appoint in writing the authorized representative.</p> <p>2. NGO shall select the authorized</p>	<p>1. NVO će pismenim putem odrediti ovlašćenog predstavnika.</p> <p>2. NVO bira ovlašćenog predstavnika,</p>

<p>cili e përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai është përgjegjës për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruara në rastin e regjistrimit të organizatës.</p> <p>3. Përfaqësuesi i autorizuar i organizatës është përgjegjës për hapjen dhe administrimin e llogarisë bankare të OJQ-së.</p> <p>4. Përfaqësuesi i autorizuar duhet të jetë rezident në Republikën e Kosovës.</p>	<p>representative, which will represent the organization and receive all official submissions on behalf of the organization. He or she shall be responsible for informing the competent authorities on any change to the data provided upon registration of the organization.</p> <p>3. Authorized representative of the organization shall be responsible for opening and administering the NGO's bank account.</p> <p>4. Authorised representative must be resident in the Republic of Kosovo.</p>	<p>koji predstavlja organizaciju i prima sve službene dokumente u ime organizacije. Odgovoran je za informisanje nadležnih organa o bilo kojoj promeni prijavljenih podataka prilikom registracije organizacije.</p> <p>3. Ovlašćeni predstavnik organizacije je odgovoran za otvaranje i upravljanje bankovnog računa NVO-a.</p> <p>4. Ovlašćeni predstavnik mora biti rezident Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 24 Regjistrimi i OJQ-së së vendit të huaj apo ndërkombëtare</p> <p>1. Për ta regjistruar degën e saj në Republikën e Kosovës, OJQ e vendit të huaj ose ndërkombëtare kërkesës për regjistrim i'a bashkëngjet dokumentet në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. dokumentin e noterizuar i cili dëshmon që OJQ është person juridik në vendin e origjinës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. adresën e degës së OJQ-së në Kosovë;</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Registration of a foreign or international NGO</p> <p>1. In order for a foreign or international NGO to register its branch in the Republic of Kosovo, it must accompany its application form with the following documents:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. notarized document proving that the NGO is a legal Person in the country of origin;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. NGO's branch postal address in Kosovo;</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Registracija inostrane ili međunarodne NVO</p> <p>1. Prilikom registracije ogranka inostrane ili međunarodne NVO u Republici Kosovo, zahtevu za registraciju se prilažu sledeća dokumenta:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. overeni dokument koji dokazuje da je NVO pravno lice u zemlji porekla;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. adresa ogranka NVO-a na Kosovu;</p>

<p>1.3. një deklaratë me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar nga selia kryesore e OJQ-së, e cila duhet të përmbajë:</p> <p>1.3.1 qëllimin dhe fushëveprimtarinë të cilën do ta ushtroj dega në Kosovë;</p> <p>1.3.2 emrin, adresën dhe kontakt-informatat tjera të përfaqësuesit të autorizuar;</p> <p>1.3.3. deklaratë e OJQ-së për zotimin se do të përmbush kërkesat e parimit për jo përfitim dhe parimet tjera të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Regjistrimi i OJQ-së</p> <p>1. Departamenti e shqyrton kërkesën për regjistrim të OJQ-së me supozimin e parimit të prezumimit të ligjshmërisë.</p> <p>2. Regjistrimi i OJQ-së bëhet me vendim i cili nxjerret nga Departamenti në afat prej</p>	<p>1.3. a written statement from the authorized representative of the NGO's seat, which must contain:</p> <p>1.3.1 purpose and scope of the branch in Kosovo;</p> <p>1.3.2 name, address and other contact information of the authorized representative;</p> <p>1.3.3. an NGO statement committing to observe requirements of the non-for-profit principle and other principles of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 NGO registration</p> <p>1. The Department reviews the application for NGO registration under the assumption of the principle of the presumption of legality.</p> <p>2. The registration of the NGO is done by a decision issued by the Department within 30</p>	<p>1.3. pismena izjava ovlašćenog predstavnika iz glavnog sedišta NVO-a, koja treba da sadrži:</p> <p>1.3.1 svrhu i delokrug koju će izvršiti ogranak na Kosovu;</p> <p>1.3.2 ime, adresu i druge podatke kontakta ovlašćenog predstavnika;</p> <p>1.3.3. izjava NVO o obavezivanju da će ispuniti zahteve principa neprofitabilnosti i drugih principa ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Registracija NVO-a</p> <p>1. Odeljenje razmatra zahtev za registraciju NVO-a uz pretpostavku principa prezumpcije zakonitosti.</p> <p>2. Registracija NVO-a se vrši odlukom koju donosi Odeljenje u roku od 30 dana,</p>
---	--	--

<p>30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës.</p> <p>3. Pas regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve, departamenti pajis me certifikatë të regjistrimit OJQ-në.</p> <p>4. Kur kërkesa për regjistrim dhe dokumentacioni i bashkëngjitur nuk është i plotë, Departamenti kërkon kompletimin e dokumentacionit. Afati nga paragrafi 2 i këtij neni, ndalet së rrjedhuri nga data e paraqitjes së kërkesës për kompletim të dokumentacionit.</p> <p>5. Afati për kompletimin e dokumentacionit për regjistrim, është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të kërkesës së Departamentit.</p> <p>6. Departamenti, pas kompletimit të dokumentacionit, merr vendim për regjistrim apo refuzim të kërkesës për regjistrim brenda afatit të mbetur sipas paragrafit dy (2) të këtij neni.</p> <p>7. Qeveria, sipas propozimit të ministrisë, nxjerr akt nënligjor, për mënyrën dhe formën e dorëzimit të kërkesës për regjistrim të OJQ-së, duke përfshirë edhe përmbajtjen e certifikatës së regjistrimit.</p>	<p>days from the date of receipt of the request.</p> <p>3. After registration in the NGO register, the Department issues a registration certificate to the NGO.</p> <p>4. Where the application for registration and the attached documentation are incomplete, the Department shall request the completion of the documents. The deadline set forth in paragraph 1 of this Article shall cease to run as of date of submission of the request for completion of the documents.</p> <p>5. The deadline for completion of the registration documentation shall be fifteen (15) days from the day of receipt of the Department's request.</p> <p>6. The department shall, upon completion of documentation, render a decision to register or reject the request for registration within the remaining time limit under paragraph two (2) of this Article.</p> <p>7. The Government shall, upon the proposal by the ministry, issues a sublegal act, on the manner and method of submitting the request for registration of NGO's, including the content of the registration certificate.</p>	<p>od dana prijema zahteva.</p> <p>3. Nakon registracije u registar NVO-a, Odeljenje izdaje NVO-u sertifikat o registraciji.</p> <p>4. Kada zahtev za registraciju i priložena dokumentacija nisu kompletni, Odeljenje zahteva kompletiranje dokumentacije. Rok iz stava 2. ovog člana prestaje da teče od dana podnošenja zahteva za kompletiranje dokumentacije.</p> <p>5. Rok za kompletiranje dokumentacije za registraciju je petnaest (15) dana od dana prijema zahteva Odeljenja.</p> <p>6. Odeljenje, nakon kompletiranja dokumentacije, donosi odluku za registraciju ili odbijanje zahteva za registraciju u roku iz stava 2. ovog člana.</p> <p>7. Vlada, prema predlogu Ministarstva, donosi podzakonski akt o načinu i obliku podnošenja zahteva za registraciju NVO-a, uključujući i sadržaj sertifikata o registraciji.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 26 Refuzimi i regjistrimit</p>	<p align="center">Article 26 Rejection of registration</p>	<p align="center">Član 26 Odbijanje registracije</p>
<p>1. Departamenti refuzon kërkesën për regjistrim, nëse:</p> <p>1.1. dokumentet e dorëzuara për regjistrim janë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji;</p> <p>1.2. me statut të OJQ-së promovohet pabarazia në njërën nga bazat të përcaktuara në Nenin 5 të këtij Ligji;</p> <p>1.3. organizata që kërkon regjistrim ka të njëjtin emër apo shkurtësë me OJQ-në e regjistruar ose të themeluar më parë, si dhe emër të njëjtë apo ngjashëm me një institucion publik aq sa mund të shkaktoj konfuzion ose të jetë çorientues;</p> <p>1.4. nëse nuk respektohen afatet kohore të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>2. Vendimi i Departamentit për refuzimin e regjistrimit bëhet për qëllime legjitime, duke ju përmbajtur parimit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit</p>	<p>1. The Department may reject an application for registration if:</p> <p>1.1. registration documents are contrary to the requirements of this Law;</p> <p>1.2. the statute of the NGO promotes inequality on any of the basis determined under Article 5 of this Law;</p> <p>1.3. organization seeking registration has the same name or acronym to a previously registered or already established NGO, and same or similar name and symbol with a public institution so as to cause confusion or to be misleading;</p> <p>1.4. if the deadlines set forth in this Law are not observed.</p> <p>2. The Department's decision to reject registration is done for legitimate purposes, by adhering to the principle of necessity and proportionality, and must contain due description of the rationale as well as the</p>	<p>1. Odeljenje odbija zahtev za registraciju ukoliko:</p> <p>1.1. dostavljeni dokumenti za registraciju su u suprotnosti sa zahtevima ovog zakona;</p> <p>1.2. statutom NVO-a se promovišu nejednakost na nekoj od osnova utvrđene u Član 5 ovog Zakona;</p> <p>1.3. organizacija koja podnosi zahtev za registraciju ima isti naziv ili sličnu skraćenicu sa registrovanim ili ranije osnovanim NVO-om, kao i isti ili sličan naziv sa jednom javnom institucijom što može izazvati zabunu ili da stvara konfuziju;</p> <p>1.4. ukoliko se ne poštuju vremenski rokovi propisani ovim zakonom.</p> <p>2. Odluka Odeljenja za odbijanje registracije vrši se u zakonite svrhe, pridržavajući se principa nužnosti i srazmernosti i treba da sadrži</p>

<p>dhe duhet të përmbajë përshkrimin e duhur të arsyeve si dhe referencën e bazës juridike.</p> <p>3.Përfaqësuesi i autorizuar mund të ankohet kundër një vendimi për refuzimin e regjistrimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Statusi Ligjor</p> <p>OJQ pas regjistrimit në Republikën e Kosovës, merr statusin e personit juridik dhe është e autorizuar të veprojë si person juridik në përputhje me legjislacionin në fuqi për persona juridik;</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Komunikimi zyrtar me OJQ</p> <p>Çdo dokument apo shkresë, konsiderohet se i është dorëzuar në mënyrë të vlefshme OJQ-së, nëse i dorëzohet përfaqësuesit të autorizuar, në formë fizike apo elektronike në adresën e përcaktuar nga OJQ.</p>	<p>reference of the legal basis.</p> <p>3. The authorized representative may appeal against a decision to reject registration, in accordance with the provisions of the Law on General Administrative Procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Legal status</p> <p>Upon registration in the Republic of Kosovo, an NGO shall have the status of a legal person and is authorized to act as a legal person in accordance with the applicable legislation on legal persons;</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Official communication with an NGO</p> <p>Any document or a letter shall be considered as validly served to the NGO, if delivered in person or by mail to the authorized representative, to the address specified by the NGO.</p>	<p>odgovarajući opis razloga i referencu pravne osnove.</p> <p>3.Ovlašćeni predstavnik može podneti žalbu na odluku o odbijanju registracije u skladu sa odredbama Zakona o opštem upravnom postupku.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Pravni status</p> <p>NVO nakon registracije u Republici Kosovo, dobijaju status pravnog lica i ovlašćena je da deluju kao pravno lice u skladu sa važećim zakonodavstvom o pravnim licima;</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Zvanična komunikacija sa NVO-om</p> <p>Svaki dokument ili pismo, smatra se da je dostavljeno na pravilan način NVO-u, ukoliko se dostavlja ovlašćenom predstavniku, u fizičkom ili elektronskom obliku na naznačenoj adresi od strane NVO-a.</p>
---	---	---

<p align="center">Neni 29 Informimi i Departamentit për ndryshimet në OJQ</p>	<p align="center">Article 29 Communication of NGO changes to the Department</p>	<p align="center">Član 29 Informisanje Odeljenja o promenama u NVO-u</p>
<p>1. OJQ informon Departamentin brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga dita e ndryshimit, lidhur me çdo ndryshim që pësojnë informatat si në vijim:</p> <p>1.1.emrin e plotë, shkurtësën e OJQ-së;</p> <p>1.2. adresën e OJQ-së;</p> <p>1.3.qëllimin dhe fushë-veprimtarinë e OJQ-së;</p> <p>1.4. emrin, adresën dhe informatat tjera kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së.</p> <p>2. Ndryshimet që i pranon Departamenti mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>3. OJQ e cila nuk përmbush detyrimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjobitet në shumë prej 150 €, ndërsa përfaqësuesi i autorizuar gjobitet në shumë prej 40€.</p> <p>4. Ekzekutimi i gjobave bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e</p>	<p>1. NGO shall inform the Department within thirty (30) days of any changes in information concerning the:</p> <p>1.1.full name, abbreviation of the NGO;</p> <p>1.2. address of the NGO;</p> <p>1.3.purpose and scope of the NGO;</p> <p>1.4. the name, address and other contact information of the NGO's authorized representative.</p> <p>2. Changes communicated to the Department are kept, registered and are made available to the public pursuant to the provisions defined under this law.</p> <p>3. An NGO that fails to meet the requirements under paragraph 1 of this Article shall be fined in the amount of € 150, while the authorized representative shall be fined in the amount of € 40</p> <p>4. The enforcement of a fine is done pursuant to the Law no. 05/L -031 on</p>	<p>1. NVO informiše Odeljenje u roku od trideset (30) dana, u vezi sa bilo kojom promenom sledećih informacija:</p> <p>1.1. pun naziv, skraćenica NVO-a;</p> <p>1.2. adresa NVO-a;</p> <p>1.3. svrha i delokrug NVO-a;</p> <p>1.4. naziv, adresa i druge kontaktne informacije ovlašćenog predstavnika NVO-a.</p> <p>2. Promene koje prihvata Odeljenje čuvaju se, registruju i stavljaju na raspolaganje javnosti u skladu sa odredbama propisanim u ovom zakonu.</p> <p>3. NVO koja ne ispunjava obavezu iz stava 1. ovog člana, kažnjava se novčanom kaznom u iznosu od 150 €, a ovlašćeni predstavnik se kažnjava novčanom kaznom u iznosu od 40 €.</p> <p>4. Izvršenje novčanih kazni vrši se u skladu sa Zakonom br. 05/L -031 o</p>

<p>përgjithshme administrative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Regjistri publik i OJQ-ve</p> <p>1. Departamenti mban dhe përditëson Regjistrin të OJQ-ve me të dhënat si në vijim:</p> <p>1.1. emrin e plotë, shkurtesën;</p> <p>1.2. numrin e regjistrimit;</p> <p>1.3. numrin fiskal;</p> <p>1.4. formën organizative (shoqatë, fondacion, institut);</p> <p>1.5. OJQ e vendit, e vendit të huaj apo ndërkombëtare;</p> <p>1.6. adresën e OJQ-së;</p> <p>1.7. qëllimin dhe fushë-veprimtarinë;</p> <p>1.8. emrat e themeluesve;</p> <p>1.9. emrin e përfaqësuesit të autorizuar;</p> <p>1.10. afatin kohor për të cilën organizata themelohet, nëse ka një</p>	<p>General Administrative Procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Public registry of NGOs</p> <p>1. The Department shall maintain and update the register of NGOs with the following data:</p> <p>1.1. full name, abbreviation;</p> <p>1.2. registration number;</p> <p>1.3. fiscal number;</p> <p>1.4. organisational form (association, foundation, institute);</p> <p>1.5. local, foreign or international NGO;</p> <p>1.6. address of the NGO;</p> <p>1.7. purpose and the scope;</p> <p>1.8. names of the founders;</p> <p>1.9. the name of the authorized representative;</p> <p>1.10. the timeframe for which the organization is founded, if applies;</p>	<p>opštem upravnom postupku.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Javni registar NVO-a</p> <p>1. Odeljenje održava i ažurira registar NVO-a sa sledećim podacima:</p> <p>1.1. pun naziv, skraćenica;</p> <p>1.2. broj registracije;</p> <p>1.3. fiskalni broj;</p> <p>1.4. način organizacije (udruženje, fondacija, institut);</p> <p>1.5. domaća, inostrana ili međunarodna NVO;</p> <p>1.6. adresa NVO-a;</p> <p>1.7. svrha i oblast delovanja;</p> <p>1.8. imena osnivača;</p> <p>1.9. ime ovlašćenog predstavnika;</p> <p>1.10. vremenski rok za koji se osniva organizacija, ako postoji;</p>
--	--	---

<p>të tillë;</p> <p>1.11.numrin dhe statusin për përfitim publik, nëse ka një të tillë.</p> <p>2. Regjistri me të dhënat e përcaktuar në paragrafët: 1.1, 1.4., 1.5., 1.7 dhe 1.11 të këtij neni bëhet publik.</p> <p>KAPITULLI VI-ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BRENDSHËM I OJQ-SË</p> <p>Neni 31 Udhëheqja e brendshme e OJQ-së</p> <p>1. Organi më i lartë drejtues i shoqatës është Kuvendi i anëtarëve, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës.</p> <p>2. Organi më i lartë drejtues i një fondacioni apo instituti është Bordi drejtues, i cili përbëhet nga të paktën tre anëtarë.</p>	<p>1.11. the number and status for public benefit, if any.</p> <p>2. The Register containing data specified in paragraphs 1.1, 1.4, 1.5, 1.7 and 1.11 of this Article shall be made public.</p> <p>CHAPTER VI-INTERNAL ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF NGO</p> <p>Article 31 Internal governance of an NGO</p> <p>1. The highest governing body of an association shall be the Assembly of members, which shall consist of all members of the association.</p> <p>2. The highest governing body of a foundation or institute shall be Governing Board, which shall consist of at least three members.</p>	<p>1.11. broj i status za javnu korist, ako postoji.</p> <p>2. Registar sa podacima utvrđenim u stavovima: 1.1, 1.4., 1.5., 1.7 i 1.11, ovog člana postaje javan.</p> <p>POGLAVLJE VI-UNUTRAŠNJA ORGANIZACIJA I FUNKCIONISANJE NVO-a</p> <p>Član 31 Unutrašnje upravljanje NVO-om</p> <p>1. Najviši upravni organ udruženja je skupština članova, koja se sastoji od svih članova udruženja.</p> <p>2. Najviši upravni organ fondacije ili instituta je upravni odbor, koji se sastoji od najmanje tri člana.</p>
--	--	--

<p>3. Organi më i lartë drejtues mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.</p> <p>4. Organi më i lartë drejtues ka përgjegjësi të plotë për çështje të politikave dhe financave të organizatës dhe takohet të paktën një herë në vit, ku shqyrton dhe miraton raportin financiar dhe të veprimtarisë së organizatës për vitin e paraprak, si dhe planin e veprimtarisë së organizatës për vitin vijues.</p> <p>5. Organi më i lartë drejtues i OJQ-së mund të delegoj kompetenca tek organet vartëse të OJQ, më përjashtim të:</p> <p>5.1. detyrave të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni;</p> <p>5.2.ndryshimeve në Statut; dhe</p> <p>5.3. vendimin për bashkim, ndarje apo shuarje të OJQ-së.</p> <p>6. Pjesëmarrja në takimin e organit më të lartë drejtues mund të realizohet edhe në distancë, përmes mjeteve elektronike, me kusht që vendimet përfundimtare të nënshkruhen nga anëtarët.</p>	<p>3. The highest governing body meets with the participation of more than half of its members and decides with the majority of the members present.</p> <p>4. The highest governing body shall have full responsibility for policy and financial issues of the organization and shall meet at least once a year, whereby it shall review and approve the financial and operational report of the organization for the previous year, as well as the organization's activity plan for the following year.</p> <p>5. The highest governing body of the NGO may delegate competencies to the NGO's subordinate bodies, with the exception of:</p> <p>5.1. Duties under paragraph 6 of this Article;</p> <p>5.2.amendments to the Statute; and</p> <p>5.3. Decisions to merge, split up, or dissolve the NGO.</p> <p>6. Participation in the meeting of the highest governing body can also be realized from the distance, by electronic means, provided that the final decisions are signed by the members.</p>	<p>3. Najviši upravni organ se sastaje učešćem više od polovine njegovih članova i donosi odluke većinom prisutnih članova.</p> <p>4. Najviši upravni organ će imati punu odgovornost za politička i finansijska pitanja organizacije, a sastajće se najmanje jednom godišnje, kada će razmatrati i usvajati finansijski izveštaj i aktivnosti organizacije za proteklu godinu, kao i plan aktivnosti organizacije za sledeću godinu.</p> <p>5. Najviši upravni organ NVO-a može preneti ovlašćenja potčinjenim organima NVO-a, sa izuzetkom:</p> <p>5.1. zadataka navedenih u stavu 6. ovog člana;</p> <p>5.2. izmena statuta; i</p> <p>5.3. odluke o ujedinjenju, razdvajanju ili raspuštanju NVO-a.</p> <p>6. Učešće na sastanku najvišeg upravnog organa može da se izvrši i iz daljine, elektronskim putem, pod uslovom da se završne odluke potpisuju od strane članova.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 32 Konflikti i interesit dhe detyrimi në lojalitet</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Conflict of interest and obligation of loyalty</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Sukob interesa i obaveza na lojalnost</p>
<p>1. Asnjë anëtar i të organit drejtues nuk i lejohet të marr pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai ka interes privat të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paañsinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit.</p> <p>2. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, të punësuarit, anëtarëve të bordit apo të organizatave të ndërlidhura, kryhet sipas vlerës së tregut ose në kushtet më të favorshme për OJQ-në.</p> <p>3. Të gjithë anëtarët dhe të punësuarit tjerë të një OJQ-je, obligohen që të tregojnë lojalitet ndaj OJQ-së, të mbrojnë fshehtësinë e informatave jo-publike dhe interesat e OJQ-së, si dhe të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me mirëbesim dhe kujdes.</p>	<p>1. Any member of a governing body shall not participate in the consideration or decision of any matter in which he or she has a direct or indirect personal or economic interest, which affect or may affect or appear to affect the legitimacy, transparency, objectivity and impartiality while exercising its function.</p> <p>2. Any transaction between an NGO and its members, employees, members of the Board, or affiliated organizations, shall be carried out at market value or under the most favourable conditions for the NGO.</p> <p>3. All members and other employees of NGO are obliged to show loyalty to the NGO, to protect the confidentiality of non-public NGO-related information and interest, and to carry out their duties and responsibilities with care and diligence.</p>	<p>1. Nijednom članu upravnog organa nije dozvoljeno učestvovanje u razmatranju ili donošenju odluka o pitanjima u kojim on ima privatne direktne ili indirektne, lične ili imovinske interese, koji utiču, mogu da utiču ili izgleda da utiču na zakonitost, transparentnost, objektivnost i njegovu nepristrasnost tokom obavljanja funkcije.</p> <p>2. Svaka transakcija između NVO-a i članova, zaposlenih, članova odbora ili povezanih organizacija vrši se prema tržišnoj vrednosti ili po povoljnijim uslovima za NVO.</p> <p>3. Svi članovi i drugi zaposleni jednog NVO-a, su dužni da iskažu lojalnost prema NVO-u, da čuvaju poverljivost ne javnih informacija i interese NVO-a, kao i da izvršavaju svoje obaveze i odgovornosti u poverenju i marljivo.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 33 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve</p> <p>Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve të larta drejtuese apo me organet e ndërmjetme dhe ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e brendshme të OJQ-së, në të kundërt çështja zgjidhet nga gjykata.</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Dispute resolution</p> <p>Disputes between members, between them and high governing bodies or with intermediate bodies and between them and employees, are resolved by consensus and in accordance with the statute and internal rules of the NGO, otherwise, the matter is subject to court resolution.</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Rešavanje sporova</p> <p>Sporovi između članova, između njih i viših rukovodećih organa ili sa srednjim organima i ili između njih i zaposlenih, rešavaju se razumevanjem i u skladu sa statutom i unutrašnjim pravilima NVO-a, u suprotnom pitanje rešava sud.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike</p> <p>OJQ nuk mund të angazhohet në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozoj, regjistroj kandidatë për poste politike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Prohibition of Fundraising, Campaigning and Endorsing Political Candidates/Parties</p> <p>An NGO may not engage in fundraising or campaigning to support political parties or candidates for political office, nor may they propose, register or in any way endorse candidates for public office.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Zabrana prikupljanja fondova, kampanji i podržavanja kandidata i političkih stranaka</p> <p>NVO se ne mogu angažovati na prikupljanju fondova ili u kampanjama za podržavanje političkih stranaka ili kandidata za političke funkcije niti mogu predlagati, registrovati ili na bilo koji način podržavati kandidate za političke funkcije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Pasuria dhe mjetet</p> <p>1. Të ardhurat e OJQ-së përfshijnë: donacionet, të ardhurat nga sigurimet, letrat me vlerë, trashëgimitë, anëtarësia, dhuratat, grantet, pasuria e tundshme dhe e patundshme, të ardhurat nga fondet e</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Property and means</p> <p>1. The incomes of an NGO may include: donations, incomes from insurance, securities, inheritance, membership, gifts, grants, movable and immovable property, incomes from invested funds, and income</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Imovina i sredstva</p> <p>1. Prihodi NVO-a obuhvataju: donacije, prihode od osiguranja, hartije od vrednosti, zaveštanja, članarine, poklone, grantove, pokretnu i nepokretnu imovinu, prihode od uloženih sredstava, kao i</p>

<p>investuara, si dhe të ardhurat e fituara përmes çfarëdo aktiviteteve të ligjshme të OJQ-së me pasurinë dhe mjetet e saj.</p> <p>2. OJQ mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saj jofitimprurëse në përputhje me nenin 11 të këtij Ligji (parimi për jo përfitim), me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike shfrytëzohen ekskluzivisht për të përmbushur misionin e saj.</p> <p>3. OJQ mund të ketë dhe të menaxhojë pronë dhe pasuri për të realizuar qëllimet e veta jofitimprurëse.</p> <p>4. Me ligj ndalohet financimi i organizatave, veprimtaria e të cilave nuk përkon me rendin juridik dhe kushtetues në Republikën e Kosovës dhe të drejtën pozitive ndërkombëtare.</p>	<p>generated from any lawful activities undertaken by the NGO with its property and means.</p> <p>2. An NGO may engage in economic activities for the purpose of supporting its not-for-profit activities, in compliance with Article 11 of this Law (the not-for-profit principle), provided that income realized through economic activities is used exclusively to fulfil its mission.</p> <p>3. An NGO may own and manage property and assets for the accomplishment of its not-for-profit purposes.</p> <p>4. The law prohibits the financing of organizations whose activity does not coincide with legal order in Republic of Kosovo and positive international law.</p>	<p>prihode ostvarene kroz bilo koju legalnu aktivnost NVO-a sa svojom imovinom i sredstvima.</p> <p>2. NVO se može angažovati u privrednim aktivnostima u cilju podržavanja njenih neprofitabilnih aktivnosti u skladu sa članom 11. ovog Zakona (princip neprofitabilnosti), pod uslovom da se prihodi koji su ostvareni putem privrednih aktivnosti koriste isključivo za ispunjavanje svoje misije.</p> <p>3. NVO može posedovati i upravljati imovinom i sredstvima radi ostvarivanja svojih neprofitabilnih ciljeva.</p> <p>4. Zakonom je zabranjeno finansiranje organizacija, čija delatnost se ne poklapa sa pravnim i ustavnim poretkom Republike Kosovo i međunarodnim pozitivnim pravom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Transaksionet financiare të OJQ-së</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 NGO financial transactions</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Finansijske transakcije NVO-a</p>
<p>Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-së, kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga BQK në llogaritë bankare të hapura në emër të OJQ-së, përveç përjashtimeve të lejuara me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>All revenues and expenditures of NGOs are carried out through financial institutions licensed by the CBK in bank accounts opened on behalf of the NGO, apart from exemptions allowed under applicable legislation.</p>	<p>Svi prihodi i troškovi NVO-a, se sprovode kroz finansijske institucije koje su licencirane od strane CBK-a u bankovskim računima otvorenim u ime NVO-a, osim izuzetaka dozvoljenih važećim zakonodavstvom.</p>

<p>KAPITULLI VII-STATUSI I PËRFITIM PUBLIK I OJQ-SË, RAPORTIMI FINANCIAR DHE PEZULLIMI I TIJ</p> <p>Neni 37 Statusi për Përfitim Publik</p> <p>1. OJQ e regjistruar sipas këtij ligji mund të paraqesë kërkesë për status të përfitim publik nëse OJQ është e organizuar dhe vepron për të ndërmarrë një apo më shumë aktivitete si aktivitete parësore si: ndihmë dhe përkrahje humanitare, përkrahje personave me aftësi të kufizuara, aktivitete bamirëse, arsim, shëndetësi, kulturë, ruajtje dhe përparim të mjedisit, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, mbrojtje dhe përparim të të drejtave të njeriut, mbështetje të praktikave demokratike dhe shoqërisë civile, promovim të punës vullnetare, mbrojtjen e konsumatorit, ndihmën dhe përkrahjen për refugjatë, zhdukjen e varfërisë, mbrojtjen apo kujdesin për shtazët e lënduara dhe të cenueshme, mirëqenien sociale, mbrojtjen nga diskriminimi, mbrojtja e trashëgimisë kulturore apo çfarëdo veprimtarie tjetër që është në funksion të së mirës së publikut.</p>	<p>CHAPTER VII-PUBLIC BENEFIT STATUS OF NGO, FINANCIAL REPORTING AND ITS SUSPENSION</p> <p>Article 37 Public Benefit Status</p> <p>1. An NGO registered under this law may apply for a public benefit status if the NGO is organized and acts to undertake one or more activities as primary activities such as humanitarian aid and support, support for persons with disabilities, charitable activities, education, health, culture, environmental protection and promotion, reconstruction and economic development, protection and promotion of human rights, support to democratic practices and civil society, promotion of voluntary work, consumer protection, refugee assistance and support, poverty eradication, protection or care for injured and vulnerable animals, social welfare, protection against discrimination, protection of cultural heritage or any other activity that serves the public interest.</p>	<p>POGLAVLJE VII-STATUS JAVNE KORISTI NVO-a, FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE I NJEGOVO OPOZIVANJE</p> <p>Član 37 Status javne koristi</p> <p>1. NVO koja je registrovana na osnovu ovog zakona može podneti zahtev za dobijanje statusa za javnu korist ako je ta NVO organizovana tako da obavlja jednu ili više osnovnih delatnosti kao što su: humanitarna pomoć i podrška, održavanje osoba sa invaliditetom, dobrotvorne aktivnosti, obrazovanje, zdravlje, kultura, očuvanje i unapređenje životne sredine, obnova i privredni razvoj, zaštita i unapređenje ljudskih prava, održavanje demokratskih praksi i civilnog društva, zaštita potrošača, pomoć i podrška za izbeglice, iskorenjivanje siromaštva, zaštita i nega povređenih i ugroženih životinja, socijalna zaštita, zaštita od diskriminacije, zaštita kulturne baštine ili bilo kojih drugih aktivnosti koje su u funkciji javnog interesa.</p>
---	---	---

